

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 240, datë 7.4.2020

**PËR VETËKARANTINIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË, TË CILËT DUAN TË
FUTEN NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NGA TË GJITHA
PIKAT KUFITARE TOKËSORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 1, germa “c” dhe 3, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik dhe Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJNË:

1. Shtetasit shqiptarë, të cilët paraqiten në pikat e kalimit kufitar tokësor, në shkelje të parimit bazë të mbrojtjes së shëndetit publik nga COVID-19, që nuk janë rezident në vende të tjera, të vetëkarantinohen për një periudhë 14-ditore, nën masa të rrepta sigurie, me shpenzimet e tyre, në struktura akomoduese pranë pikave kufitare, të përcaktuara nga Ministria e Brendshme.

2. Shtetasit rezidentë në vende të tjera nuk do të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Strukturat e Policisë së Shtetit pranë zonave kufitare të sigurojnë ruajtjen në strukturën akomoduese ku do të jenë personat e vetëkarantinuar.

4. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në këtë urdhër për vetëkarantinim për 14 ditë, të personave që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, është i dënueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

5. Ngarkohen strukturat vendore, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme, pranë pikave kufitare, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

**MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj**